



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1489/prot.
11

Tiranë më 7.12.2017.

VENDIM

Nr. 99, datë 7.12.2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Instituti i Studimeve Politike ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 1489 Prot., datë 14.11.2017, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me shkresën e datës 05.09.2017 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion duke kërkuar për sa më poshtë:

- 1. Dokumentacionin verifikues të njohjes së diplomave bachelor, MA apo PHD për studime të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për emrat e parashtruar në listën bashkëlidhur kësaj kërkesë, të cilët kanë deklaruar konfirmim për të dhëna të tilla në CV-të zyrtare dhe publike. të depozituara prej tyre pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me objektin e kërkesës, ankuesi ka depozituar ankimin nr. 1489 Prot, datë 14.11.2017 pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Për këtë çështje, Autoriteti Publik me emailin e datës 05.10.2017 i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar asistencë, gjë e cila është dhënë me anë të emailit të datës 17.10.2017. Edhe pas këtij veprimi, rezulton se Autoriteti Publik nuk i ka kthyer përgjigje kërkesit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, përsëri me emailin e datës 15.11.2017 i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni. Në tejkallim të çdo afati të përcaktuar në Ligjin për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje duke refuzuar kështu dhënien e informacionit.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Instituti i Studimeve Politike, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Gjithashtu, në shqyrtimin e çështjes gjen zbatim dhe dispozita e Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili përcakton në shkronjën b) të pikës 4, të nenit 4 se, *ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre*.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, lidhur me ankesën e Institutit të Studimeve Politike ndaj Autoritetit Publik/ Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të Institutit të Studimeve Politike, Nr. 1489 Prot., datë 14.11.2017, kundër Autoritetit Publik "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar (Dokumentacionin verifikues të njohjes së diplomave bachelor, MA apo PHD për studime të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për emrat e parashtruar në listën bashkëlidhur kësaj kërkesë, të cilët kanë deklaruar konfirmim për të dhëna të tilla në CV-të zyrtare dhe publike, të depozituara prej tyre pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve), brenda datës 15.12.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 7.12.2017.

